



Rekomandimet nga Konferenca e parë ndërkombëtare “Siguria në rrugë dhe rruga për BE” 22 dhe 23 Janar 2014	Rekomandimet nga Konferenca e dytë ndërkombëtare “Siguria në trafikun rrugor dhe sfidat e transportit në Evropën Juglindore (EJL)” 22 dhe 23 Janar 2015	Progresi i shënuar në zbatimin e rekomandimeve në periudhën kohore në mes dy konferencave	Institucionet përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve	Vërejtje
<p>1. Ndryshimi i kornizës ekzistuese ligjore sa i përket kundërvajtjeve dhe shqiptimit të dënimeve në trafik dhe harmonizimi i tyre me ligjin për sigurinë në komunikacion.</p>	<p>1. Fuqizimi i Ligjit (akteve nënligjore) për dënimin e ngasësve nën ndikimin e alkoolit, drogës, sistemi i mbledhjes së pikave, etj. Të zhvillohen sa më shumë aktivitete vetëdijësuese me qëllim të sensibilizimit të të gjithë pjesëmarrësve në rrugë (broshura, pano, fletëpalosje, TV spote me tekste dhe porosi të qarta).</p>	<p>Nuk ka përparim dhe ndryshim.</p>	<ul style="list-style-type: none">- MI- MD- KGJK- PK	
<p>2. Implementimi dhe respektimi i plotë i rregullave, akteve nënligjore të ligjit për trafikun rrugor si garantues i rritjes së nivelit të sigurisë në rrugë</p>	<p>2. Respektimi i plotë i Ligjit në fuqi për komunikacionin rrugor dhe implementimi i strategjisë për sigurinë në rrugë dhe plani i veprimit (projekt i vitit 2012, i financuar nga Zyra e BE-së në Prishtinë).</p>	<p>Nuk ka përparim dhe ndryshim nga përveç një tryeze të organizuar nga Kolegji Tempulli dhe AMRKS për strategjinë e cekur (Shkurt 2014).</p>	<ul style="list-style-type: none">- MI- MPB- PK- Zyra e BE-së në Prishtinë	

<p>3. Bashkëpunimi i mëtutjeshëm me MASHT dhe Policinë e Kosovës, të vazhdohet me sensibilizimin dhe vetëdijesimin e njerëzve, prindërve, mësuesve dhe shoqërisë në përgjithësi, në njohjen e shenjave të komunikacionit, si kusht për rritjen e sigurisë në rrugë. Bashkërendimi i aktiviteteve dhe ofrimi i bashkëpunimit duhet të bëhet me anë të publikimeve të ndryshme: medieve të shkruara dhe elektronike, broshurave, konferencave, fushatave, etj.</p>	<p>3. Bashkëpunimi në mes të institucioneve të vendit, me qëllim të përmirësimit të sigurisë rrugore dhe bashkëpunimi më shtetet evropiane ashtu që praktikatat e tyre efektive të gjejnë zbatim tek ne.</p>	<p>FKSRR së bashku me partnerët e vet ka shënuar progres në zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta për sigurinë në rrugë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - MASHT - MPB - PK - AMRKS - FKSRR - BKS 	
<p>4. Të bashkëpunohet me organet përgjegjëse me qëllim të kontrollit të kapaciteteve financiare për zhvillimin e aktiviteteve për sigurinë në rrugë, për të garantuar që fondet e destinuar publike të përdoren sipas nevojave.</p>	<p>4. Ndarja e një buxheti të posaçëm për zhvillimin e aktiviteteve për sigurinë në rrugë si dhe mbështetja e hartimit të një strategjie për të lënduarit si pasojë e aksidenteve në trafik.</p>	<p>Nuk ka asnjë përparim në institucionet qeveritare por në anën tjetër është shënuar progres me përkrahjen financiare nga BKS, OSBE, FIQ, etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Qeveria e Kosovës - MI - KK - BKS - Organizatat dhe institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare 	

<p>5. Bashkëpunimi regjional sipas planit të IRU Academy, me qëllim të harmonizimit të trajnimeve dhe kualifikimeve në transport për regjionin e Evropës Juglindore.</p>	<p>5. Bashkëpunimi i mëtutjeshëm me IRU Academy dhe realizimi i objektivave nga SEED Project që përfshijnë: trajnimin dhe kualifikimin e instruktorëve dhe ngasësve profesional, njohjen e dyanshme të certifikatave për ngasësit profesional, zgjerimin e marrëdhënieve në mes të vendeve të ndryshme, motivimin e fuqisë punëtore.</p>	<p>Sa i përket kualifikimeve dhe harmonizimit të trajnimeve për transportuesit vendor dhe ndërkombëtar të njerëzve dhe mallrave është shënuar progres i lehtë por çështja e aftësimin cilësor të shoferëve të rinj dhe organizimi i seminareve për instruktorë të ngasjes ende lë për tu dëshiruar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - IRU Academy - MI - Kolegji Tempulli - Oda Ekonomike e Kosovës 	
<p>6. T'i kushtohet më shumë rëndësi aftësimin të shoferëve të rinj, por edhe atyre të kategorive profesionale dhe të punohet në harmonizimin dhe njohjen e këtyre trajnimeve në nivelin regjional dhe ndërkombëtar si kusht i rëndësishëm për integrimin në BE. Aftësimi cilësor i shoferëve të rinj si dhe organizimi i trajnimeve periodike profesionale është faktor që ndikon në nivelin sigurisë.</p>	<p>6. Rritja e transparencës dhe forcimi i kriterëve për aftësimin e shoferëve të rinj dhe implementimi i standardeve të BE në vlerësimin e njohurive teorike dhe praktike për shoferët e rinj. Rritja e performancës profesionale dhe përgjegjësisë të instruktorëve të ngasjes dhe auto shkollave. Respektimi i Ligjit në fuqi dhe udhëzimeve përkatëse administrative të MI-së.</p>	<p>Nuk ka përparim dhe ndonjë zhvillim nga rekomandimi i vitit 2014. Vlerësohet se ka nevojë për ndryshim rrënjësor të praktikave ekzistuese në mënyrën e aftësimin, provimeve dhe pajisjes me patentshofer.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Prokuroria e shtetit - MI - PK - Auto shkollat 	

<p>7. Organizimi i shkollimit shtesë specialistikë për të gjithë ekspertët të cilët punojnë në analizë dhe ekspertizë të aksidenteve në komunikacion. Vendosija e qartë e objektivave dhe arritshmërisë dhe përfundimi mesukses i këtij specializimi, do t'i hapte rrugë Këshillit Gjygjësor të Kosovës apo Ministrisë së Drejtësisë për licencimin e ekspertëve të komunikacionit.</p>	<p>7. Ofrimi i programeve akademike në fushën e të gjitha llojeve të transportit, si kusht për qëndrueshmërinë e ambientit më të favorshëm ekonomik.</p>	<p>Nuk ka përparim dhe ndonjë zhvillim nga ana e MD dhe KGJK-së. Kolegji Tempulli ka filluar me gjeneratën e parë (specializimin) e ekspertëve për aksidente në trafik.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - MD - KGJK - FIM - Kolegji Tempulli - BKS 	
<p>8. Të gjitha dënimet mandatare të kryhen nga organet e policisë dhe jo të dërgohen në gjykata, për arsye se gjykata ka një proces të gjatë të shqyrtimit të dënimeve dhe lëndët gjyqësore jo gjithmonë mund të përfundohen me kohë, për shkak të numrit të madh të lëndëve dhe numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve.</p>	<p>8. Nga raportet e ndryshme rezulton se faktori njeri është shkaktari kryesor për aksidentet në trafik, rrjedhimisht veprimet dhe mosrespektimi i rregullave dhe shenjave të trafikut kontribuar në (mos) sigurinë në rrugë.</p>	<p>Nuk ka përparim dhe ndryshim.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Prokuroria e shtetit - KGJK - Gjykatat - Policia e Kosovës 	
<p>9. Ligji mbi sigurinë në rrugë duhet të ndryshohet dhe draftimi i ligjit të ri të mundësojë transparencë dhe të ftojë të gjitha palët e interesit për të kontribuar me propozimet e tyre për hartimin e këtij ligji.</p>	<p>9. Vetëdijesimi i qytetarëve, aplikimi i sistemit të mbledhjes së pikave për patentë shoferë, vendosja si prioritet i sigurisë rrugore dhe përkrahja nga qeveria, janë vetëm disa nga mënyrat më efektive për përmirësimin e sigurisë në rrugë.</p>	<p>Në proces e sipër me shpresë se do merren parasysh sugjerimet e dhëna nga OSBE, PK, MASHT, FKSRR DHE Kolegji Tempulli lidhur me aprovimin e Ligjit të ri për trafikun rrugor.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - MI, MD, MPB, OSBE, PK, KGJK. - Komisioni për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri. 	

<p>10. Të vazhdohet puna në përfundimin e tërësishëm të autostradës së kombit, në pjesën e Shqipërisë, duke u këshilluar me ekspertët e sigurisë rrugore. Vendosja e tabelave, ridefinimit dhe sinjalizimit shtesë është veprim që duhet marrë menjëherë me qëllim që autostrada të ofrojë siguri për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion.</p>	<p>10. Zbatimi i planit të hartuar nga Departamenti për fuqizimin e policisë për periudhën kohore 2015-2020, me qëllim të zvogëlimit të numrit të aksidenteve qoftë me lëndime trupore apo fatale</p>	<p>Nuk ka ndryshim përmbajtjesor nga rekomandimi i vitit 2014</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Qeveria e Kosovës dhe Qeveria e Shqipërisë (rekomandimi i vitit 2014). - Kuvendet komunale - MPB, MI, PK dhe institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare (rekomandimi i vitit 2015). 	
<p>11. Të merren veprime konkrete në mirëmbajtjen, infrastrukturën dhe kontrollimin e tërë autostradës, në mënyrë që në çdo kohë niveli i shërbimeve, por edhe i sigurisë në autostradë të plotësojë parametrat dhe standardet ndërkombëtare për këtë kategori të rrugës.</p>	<p>11. Të rritet përgjegjësia në qendrat e kontrollit të automjeteve, përmirësimi i gjendjes së rrugëve, shenjzimi rrugor (rishikimi i shenjzimit dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e shenjave të komunikacionit sidomos në zonat rurale, kjo pasi në zona të tilla mungojnë).</p>	<p>Nuk ka ndryshim përmbajtjesor!</p>		

<p>12. Me qëllim të rritjes së sigurisë në rrugë dhe gjendjes jo të kënaqshme teknike, të vjetërsisë së automjeteve me qëllim të ruajtjes së ambienti të favorizohet importimi i automjeteve.</p>	<p>12. Krijimi i kushteve më të volitshme për importimin e automjeteve të reja, parandalimin e qarkullimit të automjeteve të pasiguruara dhe zvogëlimi i ngarkesave dhe procedurave burokratike gjatë regjistrimit të automjeteve.</p>	<p>Nuk ka ndryshim përmbajtjesor!</p>	<ul style="list-style-type: none"> - MI - MPB - Doganat e Kosovës - Qendrat e kontrollimit teknik 	
<p>13. Të punohet në avancimin e kushteve dhe rritjen e performancës profesionale të ekipeve të cilat janë të angazhuara në terren gjatë shkaktimit të aksidentit në rrugë, duke plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme gjatë përpilimit të procesit dhe skicimit të vendit të ngjarjes. Në gjykata në cilësi të ekspertit të komunikacionit të angazhohen vetëm ekspertët e trajnuar dhe të licencuar nga KGJK – ja</p>	<p>13. Funkcionalizimi i shërbimeve mbështetëse për të gjithë pjesëmarrësit në rrugë për ndihmë në rrugë (asistencë teknike). Koordinimi dhe harmonizimi i veprimeve si dhe trajnimi i dispeçerëve, të cilët punojnë në qendrat e thirrjeve emergjente. Instalimi i një softueri për numër më të madh të këtyre qendrave dhe monitorimi i tyre.</p>	<p>Gjatë kësaj periudhe është shënuar një progres i lehtë në ofrimin e informatave lidhur me kushtet e rrugë si dhe në krijimin e kapaciteteve vendore për funksionalizimin e asistencës teknike. AMRKS tashmë ka marrëveshje me Maqedoninë dhe Shqipërinë për shtrirjen dhe ofrimin e këtyre shërbimeve mobile në rrugë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - MI - AMRKS - PK - ICITAP, - Ndihma e parë, - Brigada e zjarrfikësve, etj. 	

<p>14. Në aksidentet në rrugë, në vendin e ngjarjes duhet të dale prokurori, në mënyrë që të njihet me rrethanat e përgjithshme të shkaktimit të aksidentit dhe ecurinë e punës së ekipit të angazhuar në vendin e ngjarjes.</p>		<p>Nuk ka përparim dhe ndryshim nga ky rekomandim i vitit 2014.</p>	<p>- Prokuroria e shtetit - Gjykatat - PK</p>	
<p>15. Të vendoset bashkëpunimi regjional, por edhe ndërkombëtar si formë e përhershme e aktiviteteve të përbashkëta për sigurinë në rrugë, duke shkëmbyer eksperiencat, mendimet dhe modelet e vendeve evropiane, të cilët kanë arritur suksese të mëdha në rritjen e nivelit të sigurisë në rrugë në vendet e tyre</p>		<p>Ka progres të vazhdueshëm lidhur me këtë rekomandim të vitit 2014. Tashmë është vendosur një bashkëpunim solid me partner vendor, regjional dhe ndërkombëtar.</p>	<p>- Të gjitha institucionet e vendit por edhe ndërkombëtare .</p>	

AKRONIMET :

AMRKS – Asociacioni Kosovar i Motorizimit

BKS – Byroja Kosovare e Sigurimit

FKSRR – Forumi i Kosovës për siguri në rrugë

FIM – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

FIQ – Forumi për Iniciativa Qytetare

IRU Academy – Akademia e Unionit Ndërkombëtar për Transportin Rrugor

ICITAP – International Criminal Investigative Training Assistance Program

KK – Kuvendet Komunale

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

MASHT – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MD – Ministria e Drejtësisë

MI – Ministria e Infrastrukturës

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

PK – Policia e Kosovës

